

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 5948

Prishtinë, Dt. 17/12/2024

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji/Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Projektpropozimi	Vlerësimi i veçorive kryesore ekologjike dhe presioneve mjedisore në lumin Mirusha Assessment of the Key Ecological Attributes and Environmental Pressures in the Mirusha River
Kandidati	Arbnore Thaçi
Mentori	Prof. Dr. Halil Ibrahim
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 26.01.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 240
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Tema e masterit, "Vlerësimi i veçorive kryesore ekologjike dhe presioneve mjedisore në lumin Mirusha" e kandidatit Arbnore Thaçi është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht laboratorin e Zoologjisë të Universitetit të Prishtinës. Dorëshkrimi është i shkruar në 64 faqe me radhor normal ku janë të përfshirë këta kapituj: Hyrja, , Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Përmbledhja dhe Referencat. Gjithashtu në punim janë të prezantuar: 18 tabela dhe 16 figura. Kandidati gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të begatshme përkatësisht 35 njësi bibliografike dhe burime tjera nga interneti.</p> <p>Puna është zhvilluar sipas dinamikës së paraparë me planin dhe programin e punës dhe është realizuar në tri faza:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Hulumtimi në bazë të të dhënave të literaturës dhe puna praktike eksperimentale në teren.

2. Përpunimi i të dhënave, dhe
3. Shkrimi i tezës së masterit.

Qëllimet e kësaj teme të masterit kanë qene:




Analiza kuantitative e llojeve të Trichopterave përgjatë lumit Mirusha,
Vlerësimi i ndikimit të digave në biodiversitetin e lumit Mirusha,
Regjistrimi i gjendjes së disa llojeve të rralla të biodiversitetit dhe
Përdorimin e indeksave biotik në përcaktimin cilësisë së ujit.

Në kapitullin e Hyrjes kandidati përshkruan në përgjithësi rëndësinë e ekosistemeve ujore, grupet shtazore, rendësin e tyre dhe shkaqet e varfërimit të biodiversitetit në këto ekosisteme. Gjithashtu në këtë kapitull janë përfshirë edhe qëllimi i hulumtimit se bashku me pikat kyçe të këtij hulumtimi si dhe karakteristikat e grupeve shtazore të konstatuar gjatë këtij hulumtimi. Në kapitullin Materiali dhe Metodat e punës janë paraqitur të dhënat për përzgjedhjen e objektit të hulumtimit, mënyrën e hulumtimit në teren dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave. Në këtë kapitull shtjellohet në detaje metoda e marrjes se mostrave, konservimi i tyre si dhe determinimi. Në kapitullin Rezultatet kandidati jep detajisht të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi. Të dhënat janë paraqitur në formë tabelare dhe në formë grafike duke e pasqyruar për secilin lokalitet përbërjen e faunës së merimagave. Në kapitullin e Diskutimit kandidati i diskuton të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi me hulumtimet e kryera më pare si dhe sqaron përhapjen e disa llojeve të cilat janë gjetuar gjatë këtij hulumtimi.

Nga ajo që u tha më lartë, nga puna e bërë e kandidatit mund të thuhet se rezultatet e fituara në këtë punim paraqesin kontribut të rëndësishëm e i njohjes se veçorive ekologjike dhe presionet mjedisore në lumin Mirusha. Andaj, konsiderojmë se kandidati i ka plotësuar të gjitha kushtet për ti propozuar KSHM të Departamentit të Biologjisë përkatësisht FSHMN që të aprovojë këtë raport dhe ti lejoj kandidatit mbrojtjen e kësaj teme të masterit me titullin e lartshënuar.

Prishtinë, 17.12.2024

Komisioni:

1. Prof. Dr. Linda Grapci-Kotori – kryetar 
2. Prof. Dr. Halil Ibrahimimi – anëtar 
3. Prof. Ass. Astrit Bilalli – anëtar 

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.